



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920188

Datë: 22.06.2021

Numri i dokumentit: 01910771

Ae.nr.314/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, në çështjen juridike të paditësit [“P...”] Sh.p.k. me seli në Fsh. ..., Komuna Fushë Kosovë, kundër të paditurit [“A...”] në Prishtinë, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 7,259.58 €, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.C.454/2015 i datës 22.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 14.06.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit [“P...”] Sh.p.k., ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.C.454/2015 i datës 22.07.2019.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.C.454/2015 i datës 22.07.2019 është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit [“P...”] Sh.p.k., për ta detyruar të paditurin [“A...”] në Prishtinë, që paditësit t’ia paguajë borxhin në shumën prej 7,259.58 €, Ndërsa në pikën II është hudhur poshtë si e palejuar kundërpadia e ushtruar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës në Prishtinë. Ndërsa në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti barte shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, apo të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankese nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pretendimet nga përgjigja në ankese, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi [”P...”] Sh.p.k, ka ushtruar padi më datën 02.10.2015 me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoje kërkesëpadinë, dhe të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit në formë të fitimit të humbur t’ia paguaje shumën prej 30,000.00 €, të cilën gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka precizuar në shumë prej 7,259.58 €, me pretendim se e paditura në mënyrë të kundërligjshme e ka shkëputur kontratën me nr. Ref. ..., dt.02.09.2015 për Pyllëzimet vjeshtore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se paditësi pa asnjë arsye të vetme nuk ka filluar punimet të cilat janë të parapara me Nenin 8 dhe 9 të Kontratës nr. Ref. ..., dt.02.09.2015 për Pyllëzimet vjeshtore, andaj shkëputja e kontratës nga e paditura është e drejtë dhe e bazuar në dispozitat e Nenit 106 dhe 114 të LMD-së, dhe mbi këtë bazë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit i vlerëson të pabazuara pretendimet ankimore sepse aludohet në shkelje të dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike mirëpo në ankesë nuk theksohen asnjë shkelje konkrete e dispozitave procedurale ndërsa sa i përket gjendjes faktike e paditura nuk ka dhënë asnjë argument që do të vërtetonte gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë. Nga shkresat e lëndës rezulton qartë se paditësi nuk i ka përmbushur detyrimet e përcaktuara me kontratë andaj e paditura me të drejtë e ka shkëputur kontratën kontestuese. Pretendimet ankimore se punët nuk kanë mundur të kryhen për shkak të rrezikut sepse vend-punishtja ka qenë në pjesën Veriore të Mitrovicës, janë arsye të paqëndrueshme sepse paditësi në momentin e aplikimit është dashur të interesohet për vend-ndodhjen e punishteve dhe ta japë ofertën e tij, e jo pasi të nënshkruhet kontrata të jep vërejtje lidhur me vend-ndodhjen e vend-punishteve, sepse në momentin e nënshkrimit të kontratës krijohen obligimet kontraktuese mos përmbushja e të cilave ka pasoja juridike të caktuara, ndër të cilat i jep të drejtë palës tjetër edhe që ta shkëpusë kontratën, në rast të mos përmbushjes. Po ashtu është i paqëndrueshëm pretendimi ankimor për mos-respektim të Nenit 20 të kontratës për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve sepse paditësi nuk jep asnjë propozim apo

alternativë lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e cila në fakt nuk ekziston sepse detyrimet kontraktuale kanë qenë të qarta andaj nuk është e qartë se për çfarë mosmarrëveshje pretendon paditësi. Në fakt ankesa nuk përmban pretendime konkrete lidhur me shkaqet ankimore të parapara me LPK.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 314/2019, dt. 14.06.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli, d.v.

